

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** - Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga kryetari i trupit gjykues Agim Ademi dhe gjyqëtarëve Zyhdi Haziri dhe Sahit Borovci anëtarë të trupit, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. L., nga fshati P., Komuna e P., të cilin sipas autorizimit e mbron H. L., avokat nga Gj., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, veprës penale mbajtja në pronësi kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së dhe dy verprave penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti Për Krimeve të Rënda, PP.I.nr.123/2017 e datës 26.09.2017, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Shaban Spahiu, pas mbajtjes së seancës mbi shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, të dëmtuarit dhe të autorizuarës së tij, më datën 09.11.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari M. L.**, nga i ati H., dhe nëna M., e lindur H., i lindur me datë ... , në f. P. Komuna e P., ku edhe jeton, i martuar, baba i ... fëmijëve, i punësuar përkohësisht në S..., ka të kryer ... , i gjendjes së ... ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës e njëkohësisht edhe shtetas i Suedisë.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**I.**

Se me datë ... .2017, rrethë ores ... pas një mosmarrëveshje verbale që ka pas me të pandehurin përkatësisht të dëmtaurin H. M.dhe vllaun e tij A. M., në objektin te restorant “...” në fshatin G., Komuna e V., me qëllim të privimit nga jeta, ka dalur nga objekti i restorantit dhe në automjetin e tij ka marrë revolen e markës ..., S. me nr. serik . dhe me të njëjtën ka shtënë nëntë herë në drejtim të të pandehurit H. M., në parkingun e restorantit në fjalë dhe me këtë rast nga këto të shtëna tri predha kanë goditur trupin e të pandehurit H. M.dhe atë një predhë në regjionin e kofshës së këmbës së djethhtë, një predhë në regjionin e

shputës së këmbës së majtë, si dhe një predhë tjetër në regjionin e parakrahut të majtë, por që i pandehuri H. i ka mbijetuar plagëve të marra dhe vepra ka mbetë në tentative kurse I dëmtuari H. është dërguar për ndihmë mjekësore.

- Me çka ka kryer vepren penale vrasje në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës.

## II.

Në kohën të pa përcaktuar e deri më date 16.05.2017 në kundështrim me Ligjin mbi armët ka siguru dhe mbajtë në pronësi, armën e zjarrtë – revolen e markës „S. me nr. serik „, të cilën edhe e ka përdorë për kryerjen e veprës penale të përshkruar si në dispozitivin nr. I, të këtij aktgjykimi.

Me çka ka kryer vepren penale mbajtja në pronësi kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-së.

## III.

Se me datë, kohë si dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin I. të këtij aktgjykimi i akuzuari duke shtënë me revole ka dëmtuar pasurinë përkatësisht veturën e tani të dëmtuarit A. M. të markës “...” me ngjyrë të ... me targë të regjistrimit ... me ç’rast predhat kishin goditur pjesën e sipërme të parafangos, pjesën afër derës së parë nga ana e majtë si dhe xhamin e shoferit dhe të pasagjerit i cili edhe me këtë rast ishte thyer me këtë rast të dëmturit i kishte shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

Me çka ka kryer vepren penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPRK-ës.

## IV.

Poashtu me datën kohën si dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi i akuzuari duke shtënë me revole ka dëmtuar pasurinë përkatësisht veturën e markës “...” me tab. Regj. ... pronë e I. P., në të cilën veturë nga predhat ishte goditur dhe thyer xham i derës së pasme të anës së djathtë si dhe me një predhë ishte shkaktuar një vrimë po në të njëjtën derë ku edhe kishte mbetur predha dhe me këtë rast të dëmtuarit i kishte shkaktuar dëm material në vlerën e papërcaktuar.

Me çka ka kryer dy vepra penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPRK-ës.

Prandaj gjykata duke iu referuar marveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të shtetit dhe në bazë të neneve 3, 41, 45, 46, 47, 62, 73, 80, 83, 114 dhe 374 par.3 të KPRK-ës, nenit 233, 365, 453 dhe 463 të KPPRK-ës.

## E G J Y K O N

Të akuzuarin M. L., për veprën penale si në dispozitivin I të aktgjykimit me denim burgu prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do ta mbaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në të cilin dënim do të i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 06.09.2017 e deri me date 09.11.2017.

Për veprën penale në II të dispozitivit të aktgjykimit me denim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro,

Për veprën penale në dispozitivin III të aktgjykimit me denim burgu në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Për veprën penale në dispozitivin në dispozitivin IV të aktgjykimit me denim burgu në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Me zbatimin e dispozitave për denimin unik për veprat penale nën III dhe IV i shqiptohet denimi me burgim në kohëzgjatje prej 45 (dyzet e pesë) ditëve, e me kërkesën e të akuzuarit denimi me burgim prej 45 ditësh i shëndrrohem me denim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro. Dënimi unik me gjobë për të cilën sipas aktgjykimit obligohet ta paguaj I akuzuari është në shumë të përgjithshme prej 1.000 (njëmijë) euro, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari refuzon ta paguaj dënimin me gjobë për veprën penale sikurse në dispozitivin II atëher dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me denim me burgim duke i llogaritur nga 20 euro për një ditë burgim, deri sa nëse nuk e paguan dënimin për veprat III dhe IV do të mbajë dënimin e shqiptuar me burgim.

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i armës së zjarrtë – revole e markës ..., S. me nr. serik ... .

I dëmtuari I. P. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në contest civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50.(pësedhjet) euro si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, e gjithë kjo në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.123/2017 e datës 26.09.2017, ndaj të akuzuarit, M. L., nga fshati P., Komuna e P., për shkak të veprave penale, vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, veprës penale mbajtja në pronësi kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së dhe dy veprave penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjiilan – Departamenti i Krimeve të Rënda, Shaban Spahiu në seancën lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të mbajtur më datë 09.11.2017, mbeti në tërësi pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë e cila i është drejtuar Gjykatës më datë 09.11.2017, bazuar në dispozitën e nenit 233 të KPRK-ës, është negociuar marrëveshja me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij dhe është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë sikundër edhe dënimet, andaj i propozojmë Gjykatës që marrëveshja si e tillë të aprovohet.

Përfaqësuesi i akuzës e ka njoftuar trupin gjykues të kësaj çështje për marrjen e pëlqimit nga kryeprokurori për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë duke hequr dorë nga ndëgjimi i dëshmitarëve dhe shtjellimi i provave materiale.

Përfaqësuesja e të dëmtuarit H. M.avokatja S. M., deklaroj se dakordohem me propozimin e prokurorit lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë duke qenë se jemi marrëvesh edhe me të dëmtuarin dhe konsideroj se marrëveshja si e tillë është e ligjshme.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. L., avokat H. L., deklaron se pajtohem me thënjet e prokurorit të shtetit se sot me datë 09.11.2017 kemi negociuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe kemi arritur marrëveshjen me të akuzuarin M. L. dhe i njëjti e ka pranuar fajësinë sikurse në aktin akuzues duke i propozuar trupit gjykues që në këmbim të marrëveshjes si dhe rrethanave tjera të rastit të cilat kanë qenë me ndikim në momentin e kryerjes së veprës penale, të aprovoj marrëveshjen për pranimin e fajësisë si dhe dënimet, duke hequr dorë nga ndëgjimi i dëshmitarëve dhe shtjellimin e provave materiale.

I akuzuari M. L., deklaroi se është e vërtetë se kemi arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë në Prokurorinë e Shtetit, duke u njoftuar për pasojat dhe përparësitë e arritjes së marrëveshjes dhe propozoj që marrëveshja si e tillë të aprovohet.

Gjykata ka vërtetuar se marrëveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet, duke u bërë propozimi për marrëveshjen për pranimin e fajësisë duke e njoftuar të akuzuarin me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se këtë marrëveshje e ka bërë

në mënyrë vullnetare. Marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njehta marrëveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari i ka kryer veprat penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, veprën penale mbajtja në pronësi kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-së, si dhe dy vepra penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 të KPRK-së.

Në seancën për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që për veprën penale nga neni 178 lidhur me nenin 28, ti shqiptohet dënim me burg prej 18 (tetëmbdhjetë) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **06.09.2017** e deri më datë **09.11.2017**, për veprën penale mbajtja në pronësi kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, dënim me gjobë prej 500 euro, si dhe për dy veprat penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1, të KPRK –së dënim me burg në kohëzgjatje prej nga 30 ditë e që do të jetë dënim unik në kohëzgjatje gjithësej prej 45 ditë, i cili dënim mundë ti zëvendësohet me dënim me gjobë, e të cilin dënim me burgim prej 45 ditësh mbështetur ne nenin 47 të KPRK-së , gjykata ja ka zëvendësuar me dënim me gjobë në lartësi prej 500 euro.

Vendimi mbi dënimin plotësues konfiskimi i armës së zjarrtë - revole e markës ..., S. me nr. serik ... është bazuar në nenin 62 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 453 të KPPRK-ës.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është bazuar në nenin 463 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR.nr. 185/17 të datës 09.11.2017**

**Sekretarja juridike,**  
**Naile Neziri**

**Kryetari i trupit gjykues,**  
**Agim Ademi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.